



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1506

NR. VENDIMI 3792

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR. 1506 AKTI

NR. 3792 VENDIMI

V E N D I M

"NË EMËR TE REPUBLIKES"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARI ALTIN SHKURTI

Asistuar prej sekretares gjyqësore Suela Murataj, në Tiranë sot më datë 02.06.2021, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore publike çështjen civile me Nr. 1506 akti që i përket ndërgjyqësave.

PADITËS I KUNDËRPADITUR: ***, lindur ne *** ne ***, me leternjoftim nr. *** dhe banues ne ***

E PADITUR KUNDËRPADITËS: ***, banuese ne ***, përfaqësuar nga ***, me prokurë dat ***, Rr. ***, Cel. ***, Email. ***

OBJEKTI I PADISË: Prishjen e kontrates me ***. Kthimin e shumes prej *** Euro (me kursin e kohes) te dhene si kapar per mos permbushjen e detyrimit sipas kontrates dhe pagesen prej *** leke per shpenzimet gjyqesore dhe kohen e humbur.

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: Detyrimin e paditesit të kundepaditurit te paguaj shumen *** euro si diference te shumes totale te vendosur ne kontrate *** euro nga te cilat *** euro jane paguajtur me date 24.01.2018 2. Shperblimin e demit nga mosekzekutimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar).

BAZA LIGJORE E PADISË: Neni 659, 660, 662, 676, 693, 698, 700 K.C dhe Neni154/a K.P.C

BAZA LIGJORE E KUNDËRPADISË: Neni 160 Kodi i Procedures Civile RSh. Neni 601, 602 - Kapari, Neni 659, 660, 663, 662- Kontratat, Neni 681, 682, 686, 704 - Interpretimi i Kontrates, Neni 850, 863, 868 - Sipermanja, Neni 419, 420. 450, 460, 476/b, 481/a, 486 - Detyrime - Kodi Civil RSh

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen administroi provat shkresore dëgjoji pretendimet e fundit të palëve, palën paditëse që kërkoi pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, palën e paditur që kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë dhe pranimin e kundërpadisë dhe bisedoi çështjen në tërësi

VËREN:

Paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për prishjen e

kontrates me ***. Kthimin e shumes prej *** Euro (me kursin e kohes) te dhene si kapar per mos permbushjen e detyrimit, sipas kontrates dhe pagesen prej *** leke per shpenzimet gjyqesore dhe kohen e humbur.

Në këtë gjykim paraqiti një kundërpadi edhe e paditura *** me të cilën kërkon detyrimin e paditesit të kundërpaditurit te paguaj shumen *** euro si diference te shumes totale te vendosur ne kontrate *** euro nga te cilat *** euro jane paguajtur me date 24.01.2018 2. Shperblimin e demit nga mosekzekutimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes rezultoi e provuar se:

Rrethanat e faktit

Paditësi i kundërpaditur *** ka rënë dakort që e paditura kundërpaditëse *** të shkruante nje roman biografik, për paditësin ***. Për shkrimin e këtij libri paditësi i kundërpaditur *** dhe e paditura kundërpaditëse *** kanë formuluar dhe nënshkruar edhe kontratën përkatëse me përmbajtjen që vijon:

“Unë i nënshkruari *** kam rënë dakort me *** që të më shkruajë një roman ku subjekt do të jetë historia ime në lidhje me futbollin *** dhe *** në vecanti.

Romani do ketë *** faqe.

Të drejtat e autorit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni do jenë të autores ***.

N.q.s romani do të ketë sukses dhe do të botohet edhe në gjuhë të huaja të drejtat e autorit ndahen midis nesh në ***. Pra *** % dhe do jemi të dy bashkë që do ta lidhim marrëveshjen me botuesit e huaj.

N.q.s. romani do të ketë shansin të bëhet edhe film përsëri të drejtat e autorit do ndahen midis nesh.

Pagesa nga ana ime do jetë *** euro dhe do likujdohet me daljen e romanin në treg.

Brenda prillit romani duhet të ketë përfunduar.

Për cdo shkelje marrëveshjeje do ti drejtohem gjykatës dhe përçindja shkon në *** %”.

Paditësi i kundërpaditur i ka paguar të paditurës kundërpaditëse shumën *** Euro.

E paditur kundërpaditëse e ka përfunduar romani brenda prillit 2018. Shkrimi i perdorur ne kete roman eshte Perpetua 14 me hapesire 1.15 (e faqosur). Romani ka *** faqe dhe është përgatitur për botim me pseudonimin ***. Kete Roman e paditur kundërpaditëse e ka perfundar dhe dorezuar privatisht Z. *** ne facebook me 30 Prill 2018 ora 10:56.

Në datën 01.05.2018 paditësi pasi është njohur me librin në orën 8.50 i ka shkruajtur të paditurës kundërpaditëse: “**** ka dalë kryevepër, por ka nevojë edhe për disa shtesa”.

Në vijim ai shprehet se: “Sa e lexova”. Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se ka nevjë edhe për disa shtesa, të cilat e paditura kundërpaditur ka pranuar që ti kryejë në bazë të sugjerimeve të paditësit të kundërpaditur.

Në vijim në datën 02.05.2018 paditësi i kundërpaditur pretendon se: “Jo, da ta nis nga e para se ka shumë gjëra pa thënë dhe shumë gabim”. Ai ka kundrështuar edhe vendosjen e pseudonimit në roman duke kërkuar që rromani të botohet me emërin e të paditurës kundrëpaditëse ***. Kjo gjë nuk është pranuar nga e paditur kundrëpaditëse.

Në këto kushte paditësi i kundërpaditur *** nuk ka paguar pjesën tjerë të cmimit, pavarësisht marrjes së veprës dhe i është drejtuar gjykatës me padinë në gjykim ku kërkon prishjen e kontrates me ***. Kthimin e shumes prej *** Euro (me kursin e kohes) te dhene si kapar per mos permbushjen e detyrimit, sipas kontrates dhe pagesen prej *** leke per shpenzimet gjyqesore dhe kohen e humbur.

Ndërkohë që e paditura kundërpaditëse ***ka paraqitur një kundërpadi me të cilën kërkon detyrimin e paditesit të kundërpaditurit të paguaj shumen *** euro si diference të shumës totale të vendosur në kontratë *** euro nga të cilat *** euro janë paguajtur me datë 24.01.2018 2. Shperblimin e demit nga mosekzekutimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar).

Pretendimet e palëve

Pretendimet e paditësit të kundërpaditur

Paditësi i kundërpaditur pretendon se romani duhet të perfundonte në fund të prillit 2018 dhe do ishte ajo që do merresh me gjithcka deri në daljen në treg, pasi meqë është e tushes i di mirë rruget dhe për më tepër që ka akses edhe në media vizive dhe të shkruar dhe do bente publicitet. Kjo ishte edhe arsyeja pse i lashe 100% të drejtë autori.

Paditësi i kundërpaditur pretendon se romani do pasqyronte vertetë se kush isha unë dhe do kishte ***faqe.

Paditësi i kundërpaditur pretendon se e paditur kundërpaditëse pa u konsultuar asnjehere me të se çfarë kishte shkruajtur (përveç se njëherë me dërgon 50 faqe, por i anulloi) dhe nëse mua do më pelqente çfarë kishte shkruajtur në datën 30 prill të 2018 me dërgon romanin dhe më thote e mbarova.

Paditësi i kundërpaditur pretendon se si fillim dua të theksoj që romani kishte vetëm 302 faqe (i shkruajtur me shkronja të mëdha për të plotësuar sa më tepër faqe) ishte shumë kontraditor me ngjarjet që ajo kishte futur në roman dhe nuk pasqyronte vertetë karakterin dhe personalitetin tim, kishte futur personazhe të tjere që s'kanë të bëjnë aspak më jetën time dhe i kishte lenë shumë hapesire atyre, për më tepër janë personazhe që nuk egzistojnë vertetë. Madje për të plotësuar sa më tepër faqe kishte futur edhe fakte që s'kanë të bëjnë me subjektin e romanit autobiografik. Madje edhe emri i autorit është anonim fakt që tregon që nuk është vertetë ajo autorja e romanit, pasi unë e njoh mirë penën e saj ndërsa ai roman është shkruar nga një person tjetër amator dhe medioker.

Paditësi i kundërpaditur pretendon se i ka shpjeguar që romani nuk është ai që kerkonte dhe është munduar ta korigjonte, por po dilte që duhesh korigjuar gjithcka, madje duhesh filluar nga e para. Megjithatë edhe pse ai po e toleronte ajo tregojë arogante. Kështu vendosa ta ndërpres marrëdhënien me të edhe pse afati kishte skaduar dhe ti drejtohem gjykates.

Paditësi i kundërpaditur i kërkon gjykates që të detyroj *** të më kthejë mbrapsht *** Eurot me kursin që ishte kur ja dha pra *** leke për një euro dhe *** leke për shpenzimet dhe kohën që po humbas për procesin gjyqësor. Kështu që padia duhet të pranohet, kurse kundërpadia duhet të rrëzohet.

Prapësimet e të paditurve

E paditur kundërpaditëse prapësoi se nisur nga formimi i të paditurës ajo është kontraktuar nga paditësi i kundërpaditur ***, i cili i ka kërkuar të shkruajë një roman ku subjekti do të ishte historia e Z. *** në lidhje me futbollin *** dhe *** në vecanti. Konkretisht përmbajtja është shkrimi i një romani me përmbajtje të specifikuar kundrejt pagesës *** Euro.

E paditur kundërpaditëse prapësoi se konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: a) pelqimi i pales që merr për detyrimin, b) shkaku i ligjshëm në të cilin

mbeshtetet detyrimi, c) objekti qeformon lenden e kontrates dhe d) forma e saj e kerkuar nga ligji. Palet kane vendosur edhe klauzole per suksesin e romanit, ne qofte se ai do te botohet ne gjuhe te huaja apo do te behet film, fitimet do te ndahen ***% me *** % midis paleve.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se te gjitha keto elemente jane plotesuar per lidhjen e kesaj marreveshje (kontrate).

Vullneti;

Shkaku i ligjshem;

Objekti i shkrimi i nje romani kundrejt nje pagese;

Forma me shkrim;

E padituar kundërpaditëse prapësoi se ajo detyrohej te shkruante nje roman.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se detyrimi eshte perbushur duke e shkruar kete roman me udhezimet dhe historine e treguar nga ***, sigurisht qe duke e pershtatur historine ne nje shkrim letrar.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se ne shkrimin e Romanit ka pasur nje konsultim periodik midis paleve (kjo ne mesazhe te shkëmbyera. Shkrimi i perdorur ne kete roman eshte nje shkrim i pelqyeshem per romane, Perpetua 14 me hapesire 1.15 (e faqosur). Shkrim qe autorja ka perdorur dhe ne librat e saj. Kete Romane ka perfundar dhe dorezuar privatisht Z. *** ne facebook me 30 Prill 2018 ora 10:56. (Brenda Afatit te Marreveshjes)

E padituar kundërpaditëse prapësoi se Z. *** detyrohej te paguante *** euro dhe botimin e romanit.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se Z. *** jo vetem qe nuk e ka perbushur kontraten (kryerjen e pageses dhe botimin e librit), por ka kerkuar. Ndryshimin e tematikes se Romanit (pra futjen e elementeve dhe ngjarjeve politike - kjo jashte objektit te kontrates), si dhe ka kerkuar qe ky Iiber te mbaj emrin e ***, kjo e papranueshme per Znjsh. ***, sepse nuk ka dashur implikim me politiken dhe nga ketu kane lindur mosmarreveshje.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se paditesi i kuderpaditur ne bisedat e shkëmbyera ne facebook e ka kercenuar ***, qe nese ajo nuk angazhohet politikisht ai do ta padisi ne gjykate (sic ka bere). Paditesi i kuderpaditur, deklaroi gjithashtu ne kerkesepadi se *** euro i ka dhene me kursin e asaj dite, *** leke - *** euro, por ne ju paraqesim se kursi i dates 24.01.2018 *** euro -*** leke.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se sipas përmbajtjes së nenit 610 të K.Civil “Kapar quhet shuma në të holla që njera nga palët i jep tjetres per llogari të shumes që do t'i paguhet në baze të kontrates, me qellim që të vertetoje lidhjen e kontrates dhe të siguroje ekzekutimin e saj”.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se shuma monetare *** euro, eshte paguar per te vertetuar lidhjen e kesaj kontrate dhe per te siguruar ekzekutimin e detyrimit.

Neni 602 i K.Civil parashikon se: “Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i pales që ka dhënë kapar, kjo pale e humbet kaparin.

Pala që ka faj per mosekzekutimin e kontratës është e detyruar t'i shpërblejë pales tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij demi dhe shumën e kaparit, përvec kur në kontratë është parashikuar ndryshe “. Kështu kerkojme pagesen e *** euro, dhe shperblimin e demit, per mos ekzekutim te detyrimit nga paditesit i kuderpaditur.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se nga analiza e elemteve te kesaj kontrate kemi te bejme me kontrate sipërmarrje. Në bazë të nenit *** të K.Civil sipermarrrja eshte kontrata me te cilen njera pale (sipermarresi) detyrohet, qe me mjetet e saj dhe duke marre persiper rrezikun, te kryeje nje veper (pune), ose te beje nje sherbim apo nje

zbatim te pavarur te punimeve, ndersa pala tjetër detvrohet ta pranoje ate kundrejt cmimit te caktuar ne kontrate. Cmimi i caktuar ne kontrate per shkrimin e librit eshte *** euro.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se në bazë të neit 863 të K.Civil, porositesi perpara se te marre ne dorezim vepren e mbaruar, ka te drejte ta kontrolloje ate. Kontrolli duhet te kryhet nga porositesi, sapo sipermarresi te krijojë kushtet e duhura per kontrollin. Ne qofte se, me gjithë ftesen e bere prej sipermarresit, porositesi nuk e kryen kontrollin pa patur arsye te bazuara, ose kur nuk njofton rezultatin e kontrollit brenda nje afati te shkurter, vepra konsiderohet e pranuar. Ne qofte se porositesi merr ne dorezim vepren pa paraqitur ndonje rezerve, ajo konsiderohet e pranuar edhe pse nuk eshte kryer kontrolli.

Sipermarresi ka te drejte te kerkoje te paguhet me vleften e caktuar kur vepra pranohet nga porositesi, pervec kur ka marreveshje te kundert.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se dorezimi i vepres (Romani), eshte bere me date 30.04.2018 dhe porositesi e ka pranuar dhe kontrolluar vepren dhe nese do kishte gjetur te meta duhej te kishte lajmeruar brenda nje afati te shkurter sic specifikon dhe ligji.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se në bazë të neni 868 të K.Civil, porositesi mund te terhiqet nga kontrata, edhe kur ka filluar zbatimin e vepres ose kryerja e sherbimit, me kusht që ta kompensoë sipërmarrësin per shpenzimet e krvera, per punimet e bibra dhe per fitimin e munguar.

E padituar kundërpaditëse prapësoi se paditesit i kundepaditurit Z. ***, te paguaj shumen *** euro si diference te shumes totale te vendosur ne Kontrate (***) euro nga te cilat *** euro jane paguajtur si kapar me date 24.01.2018). Kështu që i paditësi i kundërpaditur duhet të detyrohet per shperblimin e demit nga mosekzekutimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar). Kështu që padia duhet të rrëzohet ndërsa kundërpadia duhet të pranohet.

Vlerësimi i gjykatës

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësi i kundërpaditur *** ka rënë dakort që e paditura kundërpaditëse *** të shkruante nje roman biografik, për paditësin ***. Për shkrimin e këtij libri paditësi i kundërpaditur *** dhe e paditura kundërpaditëse *** kanë formuluar dhe nënshkruar edhe kontratën përkatëse me përmbajtjen që vijon:

“Unë i nënshkruari *** kam rënë dakort me *** që të më shkruajë një roman ku subjekt do të jetë historia ime në lidhje me futbollin *** dhe *** në vecanti.

Romani do ketë ***faqe.

Të drejtat e autorit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni do jenë të autores ***.

N.q.s romani do të ketë sukses dhe do të botohet edhe në gjuhë të huaja të drejtat e autorit ndahen midis nesh në ***. Pra *** % dhe do jemi të dy bashkë që do ta lidhim marrëveshjen me botuesit e huaj.

N.q.s. romani do të ketë shansin të bëhet edhe film përsëri të drejtat e autorit do ndahen midis nesh.

Pagesa nga ana ime do jetë *** euro dhe do likujdohet me daljen e romanin në treg.

Brenda prillit romani duhet të ketë përfunduar.

Për cdo shkelje marrëveshjeje do ti drejtohem gjykatës dhe përqindja shkon në *** %”.

Nga përmbajtja e kontratës së sipërcituar rezulton se palët kanë rënë dakort që e paditura kundërpaditëse të mbajë të drejtën e autorit, ndërkohë që të drejtat ekonomike ja ka kaluar me kontratë paditësit të kundërpaditur. Në arritjen e këtij konkluzioni gjykata ka parsysh qëllimin e vërtetë të përbashkët të palëve të matreializuar në kontratën objekt shqyrtimi si dhe përkufizimet e përmbajtjen e ligjit

35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Rerefuar kontratës, gjykata cmon se e paditua kundërpaditëse ka marrë përsipër shkrimin e romanit, për llogari të paditësit * duke ruajtur të drejtën e autorit të saj, ndërkohë që të drejtat e pronësisë së romanit konform neneve 48 dhe 49 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ja ka kaluar paditëit të kundërpaditur përkundrejt pagimit të shumës *** Euro. Në përputhje me përmbajtjen e nenit 48/1 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, që përcakton se: “1. Shpërblimi për kalimin e të drejtave pasurore përcaktohet në kontratën ndërmjet palëve dhe llogaritet në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat që rrjedhin nga shfrytëzimi i veprës ose nga mënyra të tjera, duke mbajtur parasysh:**

a) tipin dhe qëllimin e veprës, për të cilën gëzohet të drejta autori;

b) suksesin e saj financiar;

c) llojin dhe volumin e veprës;

ç) kohëzgjatjen e përdorimit;

d) ekzistencën e marrëveshjes mes shoqatave të autorëve dhe shoqatave të përdoruesve, ku përcaktohet shuma e një shpërblimi të drejtë, si dhe elemente të tjera që merren për bazë në vendosjen e një shpërblimi të drejtë”, palët kanë përcaktuar edhe ndarjen e përfitimeve ekonomike.

Referuar përmbajtjes së kontratës duke interpretuar atë në përputhje me nenin 681 të K.Civil, gjykata cmon se në rastin në gjykim e padituar kundërpaditëse ka mbajtur të drejtën e autorit të romanit, ndërkohë që të drejtat ekonomike ja ka kaluar me kontratë paditësit të kundërpaditur. Për shkrimin e romanit palët kanë rënë dakort që paditësi i kundërpaditur do të paguante të paditurën e kundërpaditur në shumën * Euro. Në ndarjen e të drejtave ekonomike të veprës palët gabimisht përdorin termin “e drejta e autorit”, term që nuk i përputhet konceptit juridik që jep ligji për këtë të drejtë dhe nuk i korespondon as qëllimit të përbashkët të palëve, të cilat kanë dashur që të rregullojnë marrëdhëniet ekonomike të tyre që do të përfitoheshin nga shfrytëzimi i veprës. Paditësi i kundërpaditur i ka paguar të paditurës kundërpaditëse shumën *** Euro parapagim.**

E padituar kundërpaditëse e ka përfunduar romani brenda prillit 2018. Shkrimi i perdorur ne kete roman eshte Perpetua 14 me hapesire 1.15 (e faqosur). Romani ka * faqe dhe është përgatitur për botim me pseudonimin ***. Kete Roman e padituar kundërpaditëse e ka perfundar dhe dorezuar privatisht Z. *** ne facebook me 30 Prill 2018 ora 10:56.**

Në datën 01.05.2018 paditësi pasi është njohur me librin në orën 8.50 i ka shkruajtur të paditurës kundërpaditëse: “* ka dalë kryevepër, por ka nevojë edhe për disa shtesa”. Në vijim ai shprehet se: “Sa e lexova”. Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se ka nevjë edhe për disa shtesa, të cilat e paditura kundërpaditur ka pranuar që ti kryejë në bazë të sugjerimeve të paditësit të kundërpaditur.**

Në vijim në datën 02.05.2018 paditësi i kundërpaditur pretendon se: “Jo, da ta nis nga e para se ka shumë gjëra pa thënë dhe shumë gabim”. Ai ka kundërshtuar edhe vendosjen e pseudonimit në roman duke kërkuar që rromani të botohet me emërin e të paditurës kundërpaditëse *. Kjo gjë nuk është pranuar nga e padituar kundërpaditëse.**

Në këto kushte paditësi i kundërpaditur * nuk ka paguar pjesën tjerë të cmimit, pavarësisht marrjes së veprës dhe i është drejtuar gjykatës me padinë në gjykim ku kërkon prishjen e kontrates me ***. Kthimin e shumes prej *** Euro (me kursin e kohes) te dhene si kapar per mos permbushjen e detyrimit, sipas kontrates dhe pagesen prej *** leke per shpenzimet gjyqesore dhe kohen e humbur.**

Ndërkohë që e paditura kundërpaditëse *ka paraqitur një kundërpadi me të cilën**

kërkon detyrimin e paditesit të kundërpaditurit të paguaj shumën *** euro si diferencë të shumës totale të vendosur në kontratë (*** euro nga të cilat *** euro janë paguajtur me datë 24.01.2018). Shprehim blimin e demit nga moskërkimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se e paditura kundërpaditëse e ka përfunduar veprën, sipas përmbajtjes së kontratës duke ja dorëzuar paditësit të kundërpaditur, brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Shkrimi i perdorur në këtë roman është Perpetua 14 me hapësirë 1.15 (e faqësor). Romani ka *** faqe dhe është përgatitur për botim me pseudonimin ***. Këtë roman e paditur kundërpaditëse e ka përfunduar dhe dorëzuar privatisht Z. *** në facebook më 30 Prill 2018 ora 10:56 (Shih më hollësisht kopjen e tij të përgatitur për botim, të administruar me cilësnë e provës).

Vepra e shkruar nga e paditura kundërpaditëse është pranuar nga paditësi i kundërpaditur. Në datën 01.05.2018 paditësi i kundërpaditur, pasi është njohur me përmbajtjen e librit në orën 8.50 i ka shkruajtur të paditurës kundërpaditëse, në facebook si vijon: “*** ka dalë kryevepër, por ka nevojë edhe për disa shtesa”. Në vijim ai shprehet se: “Sa e lexova”. Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se romani ka nevojë edhe për disa shtesa, të cilat e paditura kundërpaditëse ka pranuar që ti kryejë në bazë të sugjerimeve të paditësit të kundërpaditur.

Duke pasur parasysh këto fakte gjykata cmon se e padituara kundërpaditëse e ka përmbushur detyrimet e saj kontraktore të marra përsipër. Ajo ka shkruajtur romani konform propozimeve të paditësit të kundërpaditur. Romani konform nenit 22/1 të ligjit “35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ku parshikohet se: “1. Autori ka të drejtën të njihet dhe të përmendet si autor i veprës. Kjo e drejtë ekziston në mënyrë të pavarur nga e drejta pasurore e autorit, edhe pas transferimit të të drejtave ose

tagrave të saj” është paqartuar nga autorja me pseudonimin ***. Vlen të theksohet se në kontratë palët nuk kanë përcaktuar që botimi i këtij romani do të dalë me emrin e paditëses. Në këto kushte në bazë të nenit 22/1 të ligjit “35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, mospranimi i romanit për tu botuar me emrin e të paditurës kundërpaditëse *** është në përputhje me nenin 22 të ligjit 35/2016 dhe nuk përbën mospërmbushje kontraktore nga ana e të paditurës.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor pretendimi i paditësit të kundërpaditur se romani është shkruajtur nga person tjetër amator dhe medioker mbeti i paprovuar. Paditësi i kundërpaditur nuk i paraqiti gjykatës asnjë provë që të provojë këtë pretendim.

Gjykata cmon që ndryshimi i perceptimit të romanit nga paditësi i kundërpaditur në vijim nuk përbën mospërmbushje kontraktore apo të meta të veprës, përse kohë që paditësi nuk përcakton se cilat janë mospërmbushjet, faktet e papasqyruara të sugjeruar nga ai apo faktet e shtuara që nuk duhet të ishin pasqyruar në roman. Ai nuk i paraqiti gjykatës asnjë provë që të provojë këto fakte. Kështu që këto pretendime mbetën të paprovuara. Vlen të theksohet se nga ana e të paditurës ka qenë gjithnjë gatishmëria për të plotësuar apo rregulluar mangësitë, por paditësi i kundërpaditur nuk i ka sugjeruar se cilat janë ndreqjet apo rregullimet që do të kryheshin. Ai sic deklaroi në facebook në datën 02.05.2018 ka kërkuar që ta nis romanin nga e para se ka shumë gjëra pa thënë dhe shumë gabim, por pa përcaktuar se cilat janë ato.

Duke pasur parasysh sa më sipër gjykata cmon se në rastin në gjykim nuk kemi të bëjmë me mospërmbushje kontraktore nga e paditura kundërpaditëse ***. Kështu që në çështjen në gjykim nuk ekziston mospërmbushje që të legjitimojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e shumës prej *** Euro (me kursin e kohës) të dhënë si kapar për mospërmbushjen e detyrimit, sipas kontratës dhe pagesën prej *** leke për shpenzimet gjyqësore dhe koston e humbur. Për rrjedhojë gjykata cmon se padia duhet të rëzohet.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se i padituri kundërpaditur megjithëse e ka marrë romanin brenda afatit të përcaktuar në kontratë nuk ka paguar diferencën e cmimit prej *** Euro.

Në kontratë palët kanë rënë dakort që “Pagesa nga ana ime do jetë *** euro dhe do likujdohet me daljen e romanin në treg”. Gjykata lidhur me këtë përcaktim kontraktor, cmon se ai duhet të interpretohet referuar përmbajtjes së kontratës në përputhje me nenit 681 të K.Civil që parashikon se: “Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”.

Duek pasur parsysh përmbajtjen e kontratës dhe përmbajtje e nenit 682 të K.civil ku është parshikuar se: “Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit”, gjykata konkludon se përmbajtja e këtij kushti kontraktor për likujdimin e të paditurtës së kundërpaditëse *** me daljen e romanin në treg duhet të interpretohet, sipas qëllimit të sipërcituar të përbashkët të palëve kontraktore, ku sic është sipërcituar e paditura kundërpaditëse *** ka mbajtur të drejtën e autorit duke i kaluar paditësit të kundërpaditur të drejtat e pronësisë, përkundrejt pagimit të cmimit prej *** Euro. Në përputhje me këtë përcaktim kontraktor shprehja “likujdohet me daljen e romanin në treg”, duke vlersuar sjelljen e palëve në tërësi dhe vecanërisht, pas dorëzimit të veprës, ku e paditur vazhdimisht ka kërkuar nëpërmjet komunikimit me facebook, që të paguhet diferenca e cmimit e pa paguar, cmon se ky kusht kontraktor duhet të interpretohet me përgatitjen e romanit për botim. Në arritjen e këtij konkluzioni gjykata ka parasysh sa është sipërcituar për gëzimin nga i padituri kundërpaditës të së drejtës së pronësisë së veprës dhe në përputhje me këtë të drejtë dalja e romanit në treg është një e drejtë që tashmë i përket paditësit të kundërpaditur, për shkak të tjetërsimit të sja nga autorja e paditur kundërpaditëse ***. Për rrjedhojë gjykata cmon që i padituri kundërpaditës duhet të detyrohet që ti paguajë paditëses së kundërpaditur diferencën e cmimit prej *** Euro.

Me padinë në gjykim pala e paditur kundërpaditëse ka kërkuar edhe shperblimin e demit nga mosekzekutimi i detyrimit (humbja e pesuar dhe fitimi i munguar). Gjykata cmon se në rastin në gjykim pala paditëse e kundërpaditur duhet të shpërblejë palën e paditur kundërpaditëse dhe për kamatvonesat në ekzekutimin e detyrimit të shumë *** Euro. Për sa kohë që pala e paditur kundërpaditëse nuk vërteton investimin e kësaj shume në ndonjë aktivitet tregtar fitimprurës, gjykata konkludon se fitimi i mungura i kësja pale përbehet nga intersi me lartë bankar. Për rrjedhojë pala paditëse e kundërpaditur duhet ti paguajë palës së paditur kundërpaditëse edhe kamat vonesat ligjore, të përbëra nga interesi më i lartë bankar nga 01.05.2018 deri ne daten e ekzekutimit te ketij vendimi, konform nenit 450 të K.Civil..

Nga sa argumentuam më sipër gjykata cmon që padia duhet të rrëzohet, ndërsa kundërpadia duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, duke u bazuar në nenet 306 e vijues të K.Pr.Civile,
V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesëpadisë.

Pranimin e kundërpadisë.

Detyrimin e paditësit te kundërpaditur * qe ti paguaj te paditures kunderpaditese ***, shumen *** Euro, qe perben cmimin e papaguar sipas cmimit te percaktuar ne**

kontrate si dhe kamat vonesat ligjore (interesi me i larte bankar) nga data 01.05.2018 deri ne daten e ekzekutimit te ketij vendimi.

Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga permbaruesi gjyqesore.

Detyrimin e paditesit te kunderpaditur * qe te paguaj shpenzimet e kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tirane per njoftimet e paleve.**

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit te kunderpaditur.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë sot me datë 02.06.2021

S E K R E T A R E

SUELA MURATAJ

G J Y Q T A R I

ALTIN SHKURTI